

SYLLABUS

Fakulteti: Shkencat Kompjuterike

LËNDA:	Programimi në Ueb (ASP.NET) (WEB Programming - ASP.NET)	
Niveli i kursit:	Bachelor	
Lloji i kursit:	Obligative	
Viti i studimeve	Viti II	
Semestri:	Semestri IV	
Kodi dhe shifra e lëndës:		
Koha/lokacioni: Ligjëratat: Ushtrimet:		
Mësimdhënësit e kursit:		e-mail:
	1. PhD/c. Arben Ahmeti	arben.ahmeti@riinvest.net
	2. Arbër Kukaj	arber.kukaj@riinvest.net

1. Përshkrimi i lëndës

Ky kurs mëson teknikat eficiente të dizajnit dhe programimit të web-aplikacioneve. Temat që do të shtjellohen në këtë kurs janë: arkitektura e web-aplikacioneve, konfigurimi, konektimi me baza të të dhënave, validimi i të dhënave, keshimi (caching), etj. Teknikat e programimit dhe dizajnit të web-aplikacioneve do të demonstrohen duke përdorur probleme praktike.

2. Qëllimet e lëndës

Studentët do të njoftohen me programimin e web-aplikacioneve, të cilat paraqesin llojin e aplikacioneve më të përhapura (interneti).

3. Rezultatet e pritura

Dijet dhe shkathtësitë teorike dhe praktike që pritet të arrihen nga studentët.

Studentët do të jenë në gjendje të programojnë dhe dizajnojnë web-aplikacione që në sfond kanë një bazë të dhënash. Konektimi me bazën e të dhënave, manipulimi dhe azhurimi i të dhënave me qëllim të krijimit të web-aplikacioneve dinamike do të jenë disa nga rezultatet e pritura.

Pas përfundimit të këtij kursi studentët do të jenë në gjendje të:

- Krijojnë, konfigurojnë dhe dizajnojnë web-aplikacione,
- Krijojnë module që sigurojnë funksionalitetin e web-aplikacioneve,
- Manipulojnë baza të dhënash duke mundësuar paraqitje dinamike të web-aplikacioneve,
- Validojnë të dhënat që paraqiten në Web.

Për veç shkathtësive kompjuterike në këtë kurs studenti do të zhvillojë:

- Shkathtësitë për dizajnim,
- Shkathtësitë e komunikimit dhe prezantimit,
- Shkathtësitë e punës në ekip.

4. Metodologjia

Në orët e ligjëratave, do të shtjellohet materiali mësimor, do të organizohet diskutime rreth problemeve praktike.

Në ushtrime, krahas zgjidhjes së detyrave nga lënda mësimore, do të zhvillohen diskutime për problemet e ndryshme si dhe format e ndryshme të zgjidhjeve të dorëzuara nga studentët.

5. Literatura

Tekstet:

- "Learn ASP.NET Core 3, Second Edition, Kenneth Yamikani Fukizi, Jason De Oliveira, Michel Bruchet, ISBN 978-1-78961-013-0"
- "Pro ASP.NET Core 3" - Adam Freeman, ISBN-13 (electronic): 978-1-4842-5440-0.
- "Apress - Beginning ASP.NET 4.5 in C#, 5th. Edition, Matthew MacDonald [2012], ISBN-13: 978-1430242512,

On-line resurset:

-

6. Plani i mësimimit	Titulli i Ligjëratës	Aktivitetet
	Web-aplikacionet Hyrje, Arkitektura	Karakteristikat e ueb-aplikacioneve, arkitektura dhe veçoritë e ASP.Net
	ASP.Net Core MVC Framework	Mundësitë e zhvillimit të ueb-aplikacioneve përmes modelit model-view-controller
	ASP.Net MVC - Views	Shtjellim i mëtutjeshëm i Views
	ASP.Net MVC - Controllers	Shtjellim i mëtutjeshëm i Controller-ëve
	ASP.Net MVC - Models	Shtjellim i mëtutjeshëm i Models
	MVC Routing, ASP.Net MVC HTML Helpers	Shtjellimi i rutimit në MVC aplikacione, rutimi tradicional dhe përmes attributeve. Shtjellimi i HTML libraritë për të gjeneruar HTML markup
	ASP.NET Web API	Shtjellimi i Web API-ve
	Validimi i të dhënave, trajtimi i gabimeve dhe Siguria në Web-aplikacione	Shtjellimi i validimit të të dhënave, trajtimit të gabimeve dhe Siguria në Web-aplikacione
	ASP.Net Ueb Aplikacionet (ASP.Net Ueb-format dhe Ueb-kontrollat)	Arkitektura e ueb-aplikacioneve, ueb-format në ASP.Net, Ueb-kontrollat e gatshme në ASP.Net, roli dhe mundësitë e tyre
	Menaxhimi i gjendjeve (State management), keshimi	Çfarë është menaxhimi i gjendjeve dhe keshimi, rëndësia dhe aplikimi
	ADO.NET	API-t dhe teknikat e konektimit me baza të të dhënave, ekzekutimi i query-ve nga një ueb-aplikacion ASP.Net
	Rekapitulim i lëndës	

8. Politikat akademike dhe rregulloret e mirësjelljes

Studentët janë të obliguar të përcjellin me rregull ligjëratat dhe ushtrimet. Ata duhet të vijnë me kohë në mësim, të mbajnë qetësinë dhe të angazhohen aktivisht në dialog në ligjëratat. Gjatë kohës së mësimi duhet studentët duhet t'i shkyçin telefonat celularë.

9. Metodatat e vlerësimit

Detyra 1: 15%

Detyra 2: 15%

Detyra 3 (opcionale): 5%

Provimi mes semestral: -

Pjesëmarrja në Ushtrime dhe Ligjëratat: 0%

Provimi Final: 70%

Shënim: Realizimi i detyrës 3 është opcional. Për realizimin e detyrës 3 studentët duhet të angazhohen individualisht, nuk lejohet puna në grup. Detyra 1 dhe 2 ipet si një projekt me dy faza. Për realizimin e detyrës 1 dhe 2 lejohet krijimi i grupeve me dy anëtarë. Vonesat e dorëzimit dhe mbrojtjes së projektit do të penalizohen me nga 1 pikë për secilën detyrë.